

INFORMACION MBI TAKIMIN E FNAI-t PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE

Me dt 19.03.2021 -Ora 12.00 ,në platformën Zoom u realizua një takim me

- zj.Mimoza Hysa Culiqi,Drejtoe e Qendrës së botimeve për Diasporën
- av.Luljeta Çobanaj, Oficeren e Min.së Diasporës pranë Konsullatës Shqiptare Milano
- aktivistë nga lidhja e mësuesve Itali.

Në takim ishin të ftuar nga FNAI edhe Margita Hoxha.Erida Çela Perlala,Granit Muçaj dhe Petrit Aliaj.Në takim ishin gjithsej 16 persona .Për efekt të orarit jo të volitshëm nuk u arrit që të kishte një pjesëmarrje të gjërë.

Tema e takimit ishte bashkëbisedim i hapur per ceshtjet e meposhtme:

1. Kërkesat e teksteve mësimore për fëmijët që ndjekin gjuhën shqipe në kurset dhe shkollat në Itali në bazë të listave me nr. e fëmijve si mbas moshave të cilat do tu nisen Ambasadës dhe konsullatave Shqiptare në Itali.
- 2.Parashikimi i iniciativave për hapjen e shkollave të reja dhe përfshirja e tyre në kërkesat për materiale shkollore .
3. Si mund të mundësohet hapja e shkollave në gjuhën shqipe dhe arbërisht aty ku ka përqëndrim të minorancave Arberëshe, edhe në bazë të përfitimeve që rrijellin nga ligji 482/1999
4. Rregjistrimi i mësuesve ,përfshirë edhe ata që i kanë plotësuar dokumentat në bazë të kërkesave përfshirë edhe ndihmën kundrejt të tjerëve në plotësimin e dokumentacionit.
- 5.Idetë për organizimin e punës për vitin mësimor në vazhdim si edhe të 2021 - 2022.

Problemet që u trajtuan:

- Kërkesat për librat si një fakt i pa mundësisë së shpërndarjes së tyre nga Lidhja e Mësuesve u propozua që ato të shpërndahen në konsullatat e Shqipërisë në Bari, Milano si edhe në Ambasadën e Shqipërisë në Romë.

- Në takim nga komentet e drejtuesve të Lidhjes së Mësuesve Itali, u shfaq një klimë absurditeti dhe xhelozie për sa i përket drejtimit të shkollave shqipe nga shoqatat tona, duke i konsideruar këto shkolla cilat si një monopol të tyre, pa shfaqur asnjë shenjë mirënjoihe për punën, angazhimin, sakrificat e stafëve të këtyre shoqatave dhe të mësuesve tanë. Sigurisht manifestime të tilla u dënuan nga disa folës si edhe organizatorët e takimit për faktin se indiferenca e drejtuesve të kësaj lidhje ka dëmtuar maksimalisht bashkëpunimin me Federatën tonë si rezultat i frymës së bajraktarizmit dhe përçmimit ndaj aftësive të drejtuesve të shoqatave. Qëndrimet tona ishin të prera ndaj iluzioneve dhe fryjeve si edhe të hapura për bashkëpunim dhe për të mbështetur lidhjen e mësuesve në të gjitha drejtimet.

- Ndër të tjera të ashpëra ishin komentet për sa i përket certifikimit të mësuesve për faktin se ato po sjellin pakënaqësi dhe përçarje në mes tyre. Fakti që mësuesit prej shumë vitesh po mësojnë vullnetarisht fëmijët tanë edhe pse nuk janë vlerësuar dhe përkrahur asnjë herë nuk mund të hidhen si limon i shtrydhur. Për më shumë, certifikimi i mësuesve kërkon edhe dokumeta të tjera noteriale ku për rastin në takim pati kundërshti në diskutime. Kundërshti të cilat Qeveria Shqiptare duhet ti ketë parasysh se këta mësues e drejtues të shoqatave i kanë ngritur këto kurse e shkolla pa ndihmën e shtetit me shpenzimet e tyre si për lokalet por edhe për të tjera sende që kërkon një klasë.Pra shteti më parë se të kërkojë duhet të bashkëpunojë,të mbështesi e të vlerësojë aktin e këtyre mësuesve atdhetar të cilët janë ata rojet e ruajtjes së gjuhës tonë nga asimilimi .Edhe për sa i përket teksteve u propozua që krahas tyre të hartohen libra për krijimtarinë tonë muzikore e letrare për tu mësuar fëmijëve këngët dhe poezitë tona .

Në lidhje me hapjen e shkollave të gjuhës shqipe Arbërisht në disa katunde të Kalabrisë nga disa diskutantë u theksua domosdoshmëria e bashkëpunimit sa më të shpejtë të qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane për faktin se ligji 482/1999 jo vetëm që pengon hapjen e shkollave shqipe në Itali por edhe na penalizon duke u nisur nga Neni 3 i cili përcakton se zbatimi i dispozitave për mbrojtjen e pakicave gjuhësore miratohet nga Këshilli i Provincave në bazë të kërkesës së Bashkive në të cilat duhet të jenë 15% e qytetarëve të rregjistruar në listat zgjedhore (lexo me shtetësi Italiane) ose nisur nga kërkesa e 1/3 e këshilltarëve të të njëjtave komuna.

Për sa më sipër në emër të Këshillit Drejtues të Federatës do të analizojë të gjitha problemet e më sipërme për të hartuar një Notë-Kërkesë të nisjes së bisedimeve për ratifikimin e ligjit 482/1999 për të arritur mlësimdhënien e gjuhës shqipe në instuticionet në të cilat mësojnë fëmijët tanë kur arrijnë numrin 12 .

Me këtë rast ju bëj thirrje që të na dërgoni të gjitha propozimet dhe idetë tuaja në gjetjen e një zgjidhje të mundëshme. Një kohësisht duhet të dërgoni me email emrat e mësuesve si edhe parashikimet e nr. të nxënësve për sezonin e ri shkollor 2020-2021 në mënyrë që të arrijmë të furnizohemi me tekste në muajin Maj.